Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial .....	
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike .....	
Shtojca 6. Formulari i sasisë dhe Grafiku i lëvrimit .....	
Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....	
Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....	
Shtojca 9. Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....	
<a href="#">Shtojca 10. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak).....</a>	
<a href="#">Shtojca 11. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)</a>	
<a href="#">Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)</a>	
<a href="#">Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)</a>	

---

## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontrates;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
    7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
  - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

---

## Shtojca 1/1.

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në cmim me te ulet*]

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;

- 
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>
<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i mallrave</b>	<b>Norma e fitimit</b>

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik )

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					

---

<b>TVSH (%)</b>	
<b>Çmimi total me TVSH:</b>	
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> <b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	



---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

---

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

NR	PERSHKRIMI	Specifikimet
1	Leter A4 (500 fije) [80gsm, 210mm x 297mm]	Letrat të jenë origjinale dhe të cilësisë së parë. Të jetë CIE bardhësi $169\pm 3$ , dimensionet: 297x210mm. Pesha e një fije të jetë 80 gr/m <sup>2</sup> dhe një rizme (500 fije x A4), Lagështira: 3.5-4.5 %. Trashësia: 104-112µm. Drita : $\geq 94\%$ . Shkelqimi : 101-114%, Të mos jete e ricikluar, Letra të ketë mbështjellje kundër lagështirës. Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in. Të qëndroje e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit. Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit. Të jetë e

		përshtatshme për printim në të dyja anët. Të plotësojë standartet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë. Nje kuti te permbaje 5 risme
2	CD/ DVD	Këto CD duhet të mbajnë deri në 800 Mb ose jo më pak se 90 minuta regjistrim. Shpejtësia e shkrimit të diskut deri në 40x. Secili disk te kete kutine (kapakun) e tij. Te kene nje shtrese mbrojtese ekstra kundra gervishtjeve.
3	Dosje me llastik (thellësi 6cm)	Kjo dosje të jetë prej kartoni te presuar dhe te plastifikuar dhe shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentat tuaja të rëndësishme. Ajo mbyllet me ndihmën e një llastiku, në mënyrë që të ruajë sa më mirë materialet në brendësi si dhe për t'u lëvizur lehtësisht. Me llastik të gjerë. Përmasat 32±0.5cm x 24±0.5cm x 6±0.5cm. Me trashësi të kartonit ≥ 600gm <sup>2</sup> .
4	Dosje arkive me mekanizëm, 6 cm	Kjo dosje me mekanizëm shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentet duke i kapur me mekanizëm. Ajo duhet të ketë një mekanizëm metalik, i cili i mban dokumentat të mbërthyer me anë të dy shufrave dopjo në të cilat vendosen letrat A4 pasi janë hapur vrimat përkatëse me hapëse vrimash dopjo ose qeset mbajtëse përkatëse. Gjithashtu, duhet të ketë një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Materiali te jete polipropilen me shkelqim. Te jete lehtesisht elastike. Gjerësia e dosjes 6 cm
5	Dosje Arkive me buton	Dosje me buton me thellësi 15±0.5cm, material polipropileni ose ekuivalent. Kjo dosje me buton shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentet tuaja të rëndësishme. Gjithashtu, ajo ka një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Përmasat 240±5mm x350±5mm. Mundesisht te kete nje vrime e cila lejon terheqjen e saj sa me lehte nga arkiva.
6	Qese plastike A4	Pako me 100 qese plastike prej materiali polipropilen, transparente dhe me madhësi A4, me spesor jo më pak se 100 mikron. Këto qese mund të përdoren me të gjitha llojet e lidhësve të unazave si një mënyrë për të mbrojtur dhe renditur dokumentet. Çdo qese të ketë kapacitet mbajtës jo më pak se 40 fletë A4 80gm <sup>2</sup> secila.

7	Makinë kapse Aktesh (Stapler)	Makina për kapse aktesh (Stapler), të jetë metalike dhe me material çelik, ose ekuivalente, i pandryshkshëm ose i kromuar në formë pince (dore). Makina të jetë përshtatshme për të kapur deri në jo më pak se 45 fletë të gramaturës 80 gr/m <sup>2</sup> . Të përdoret me tela/kapëse 24/6, 26/6, 26/8 dhe 24/8.
8	Makinë kapse Aktesh e Madhe (23/6-23/24)	Makinë kapëse aktesh prej materiali metalik. Makina të jetë përshtatshme për të kapur deri në jo më pak se 200 fletë të gramaturës 80 gr/m <sup>2</sup> . Gjithashtu ajo duhet të kapi dhe me pak fleta në varësi të përdorimit duke ndërruar numrin e telave. Te kete depozite per te vendosur telat. Çdo informacion shtesë për numrin e telave që përdoren në varësi të fletave duhet të jenë të shpjeguara dhe në trup të produktit. Telat te jene nga 23/6 deri 23/24.
9	Tela/kapëse 24/6;	Kapëset/tela të jenë të dizajnuara me material të cilësisë së lartë, te galvanizuar dhe të jenë parashikuar për të shpuar pastër përmes fletëve të shumta të letrës pa u këputur ose shqyer letrën. Të jenë prej metali të kromuar ose të pandryshkshëm. Te kapi deri ne jo me pak se 30 flete te gramatures 80gr/m <sup>2</sup> . Paketimi 1000 copë.
10	Kapse me vesh 25mm;	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e preferueshme, e zezë. Paketimi jo më pak se 12 copë.
11	Kapse me vesh 41mm;	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e preferueshme, e zezë. Paketimi jo më pak se 12 copë.
12	Kapse me vesh 63 mm	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e preferueshme, e zezë. Paketimi jo më pak se 12 copë.
13	Korrektor stilolaps	Korrektor në formë stilolapsi që shërben për korrigjimin e gabimeve të bëra gjatë shkrimit. Siguron mbulim të mirë dhe thahet shpejt duke lënë një shtresë të butë mbi të cilën mund të shkruhet sërish.
14	Kapëse "U" 28mm	Kapëse dokumentash, 28 mm. Të jetë ideale për të kapur letra apo dokumente të ndryshme në zyrë, shkollë etj. Të jetë e ndërtuar me material çeliku të qëndrueshëm. Paketimi në pako me jo më pak se 100 copë kapëse.

15	Stilolaps i zakonshëm me majë sferike blu	Stilolaps i tipit ballpoint me majë 0.7mm-1mm. Të mos krijojë ngecje apo rrjedhje boje gjatë shkrimit.
16	Tampon vule blu	Tampon vule i mesëm me kuti metalike. Përmasat 80mm ± 10mm x 150mm ± 10mm.
17	Bojë vule blu	Bojë për të gjitha llojet e vulave. Bojë e pastër mjedisore dhe shumë rezistente. Jo toksike. Paketimi në shishe plastike jo më pak se 20ml.
18	Lapsa HB	Lapsi prej grafiti të jetë i prodhuar nga materiale sintetike, që do të thotë se nuk lëshon cifla në rast se thyhet, si dhe të jetë rezistent ndaj shtypjes dhe përdorimit. Shkalla e grafitit të jetë HB. Lapsat te jene jo toksik.
19	Evidenciator (highlighter) ( pako me 4 ngjyra te ndryshme)	Evidenciator (highlighter). Evidenciatori të ketë një majë të petëzuar e cila ndihmon për nënvijëzime ose evidentime. Të ketë ngjyrë të hapur (jo të errët dhe të mundësojë shikimin lirshëm të shkrimit në dokumente pasi vijëzohet mbi të), e cila thahet menjëherë dhe nuk është toksike. Maja e vijëzimit të jetë minimumi 5mm.
20	Stick ngjitës	Ngjitësi nuk duhet të jetë toksik dhe nuk duhet të përmbajë acid duke shmangur kështu dëmtimin e materialeve në të cilat përdoret. Material PVP ose ekuivalent. Paketimi jo më pak se 35g në formë cilindri roller.
21	Mbajtëse kancelarie	Mbajtëse kancelarie me set i cili perbehet minimumi nga 12 produkte. Në këtë set duhet të përfshihen minimalisht këto produkte: mbajtësja e rrotullueshme e kancelarive, laps, stilolaps, gërsërë, vizore, prefëse lapsi, kapse letrash etj. Mbajtësja të jetë prej materiali plastik ose ekuivalent. Preferohet ngjyrë e errët.
22	Heqëse telash stapler	Heqëse teli ne forme pince e përbërë nga material metalik ose ekuivalent. Të heqë të gjitha llojet e telave standarte. Të jetë i përshtatshëm për perdorim zyre.
23	Bloq letrash me ngjitje	Bloqe me ngjitje 75mm±1mm x 75mm±1mm me 500 fletë me ngjyra të ndryshme. Letrat ngjitëse shërbejnë për të nxjerrë në pah mesazhet e rëndësishme dhe ngjiten edhe mbi sipërfaqe të vështira. Ato mund të përdoren për të shënuar lajmërimi,shënime etj.
24	Makinë llogaritese	Makinë llogaritëse tavoline me jo më pak se 12 shifra të shfaqura në ekran.Trup me formë elegante me hark. Ekran i madh me pjerrësi të rregullueshme. Burim energjie me bateri dhe diellore. Me opSION Tax+ dhe Tax, po ashtu edhe me

---

		opsion per kembimin valutor. Zgjedhje rumbullakimi dhe presje dhjetore. Fikje automatike.
25	Gershere	20.5 cm, inoksi
26	Bllok shënimesh (Note book)	Bllok shënimesh me kapak të fortë (hard cover). Minimumi me 100 fletë. Në format shkrimi me ndarje horizontale të barabarta.
27	Zarfa A4 , 23 x 33	500 copë kutia
28	Zarfa A3 , 19 x 26	500 copë kutia
29	Pen drive 16 GB, shpejtësia 3.0	16 GB, shpejtësia 3.0
30	Pen drive 32 GB, shpejtësia 3.0	32 GB, shpejtësia 3.0

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

#### Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Leter A4 (500 fije) [80gsm, 210mm x 297mm]	kuti	484
2	CD/ DVD	cope	200
3	Dosje me llastik (thellësi 6cm)	cope	400
4	Dosje arkive me mekanizëm, 6 cm	cope	200
5	Dosje Arkive me buton	cope	400
6	Qese plastike A4	pako	400
7	Makinë kapse Aktesh (Stapler)	cope	50
8	Makinë kapse Aktesh e Madhe (23/6-23/24)	cope	20
9	Tela/kapëse 24/6;	pako	1000
10	Kapse me vesh 25mm;	pako	100
11	Kapse me vesh 41mm;	pako	50
12	Kapse me vesh 63 mm	pako	200
13	Korrektor stilolaps	cope	500
14	Kapëse "U" 28mm	pako	100
15	Stilolaps i zakonshëm me majë sferike blu	cope	3000
16	Tampon vule blu	cope	20



17	Bojë vule blu	cope	20
18	Lapsa HB	cope	1172
19	Evidenciator (highlighter) ( pako me 4 ngjyra te ndryshme)	pako	300
20	Stick ngjitës	cope	200
21	Mbajtëse kancelarie	cope	50
22	Heqëse telash stapler	cope	100
23	Bllok letrash me ngjitje	cope	500
24	Makine llogaritese	cope	50
25	Gershere	cope	50
26	Bllok shënimesh (Note book)	cope	100
27	Zarfa A4 , 23 x 33	kuti	50
28	Zarfa A5 , 19 x 26	kuti	50
29	Pen drive 16 GB, shpejtësia 3.0	cope	15
30	Pen drive 32 GB, shpejtësia 3.0	cope	15

**Afatet e lëvrimit:**

**5 DITE NGA DATA E NENSHKRIMIT TE KONTRATES**

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

---

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

---

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**4.2.1.** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të viteve 2021, 2022 dhe 2023, lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së parshikuar të kontratës. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

**4.2.2.** Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2021, 2022 dhe 2023 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivi. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**4.2.3.** Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të perfshihet kesti për periudhën perkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të

---

Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mesipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor vetem nga operatori I shpallur fitues përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës. Për të provuar përvojën e mëparshme, duhet që:

a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten kontrata e shërbimit dhe faturën tatimore të shitjes(situacionet), ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.

b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten fatura tatimore të shitjes (situacionet), ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve “a” ose “b” e bën ofertën të kualifikueshme

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion për disa nga mallrat objekt prokurimi, të përcaktuara me nr. Rendor: 1,3,5,6,15,19,21,26 sipas listës së publikuar nga autoriteti kontraktor në Shtojcën nr. 6.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.

Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat që do të dorëzoje do të jenë të njëjtë me mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

### **Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.**

**2.3.3** Per artikullin leter A4, OE duhet te paraqese skeden teknike te certifikuar nga prodhuesi, ku te pasqyrohen specifikimet teknike te kerkuara, si dhe autorizim nga prodhuesi apo distributori I autorizuar.

---

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

**Operatorët ekonomikë, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

---

**Shtojca 8**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

<b>Emri i nënkontraktorit të propozuar</b>	<b>NIPT –i</b>	<b>Përqindja e nënkontraktimit</b>	<b>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar</b>

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<b>Emri (at) e subjekteve</b>	<b>NIPT-i</b>	<b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b>	<b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b>

## **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

### **A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

#### **Deklarata**

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_



Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

## **B: DEKLARATA**

### **Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
  - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
  - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e

konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit). □

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
  - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
  - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
  - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

## C: DEKLARATA

### Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
<p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrit, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i</li></ul>

barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

